



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr.

406

Data: 12 . 01 . 2024

PROCESVERBAL I PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

Procesverbali nga Plani i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024, të mbajtur me datën 26.12.2022, duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Konferencës – Qendra e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit, me gjithsej 21 pjesëmarrës/e, prej tyre 7 gra dhe 14 burra. Për prezentimin e Planit, prezent ishte **Mehmet Ballazhi** (Kryetari i Komunës), **Sevdi Derrjani** (Nënkryetar i Komunës), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoresh e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme), **Arsim Derrjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport) dhe **Nexhmedin Daci** (Drejtor përbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), si dhe nga Kabineti, zyrtarë të drejtorive përkatëse, si dhe qytetarë nga Hani i Elezit me rrethinë.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës z. **Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin publik mbi Planin e Punës së Kryetarit të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2024 dhe theksoi se ky Plan do të prezentohej shkurtimisht nga ai pasi që materiali i plotë ishte shpërndarë, i publikuar në webfaqe, si dhe për të plotësuar do të jenë të gatshëm drejtorët/et komunale.

Me këtë rast, Kryetari falënderoi në veçanti zyrtarët komunalë që kanë qenë të drejtëpërdrejtë në kryerjen e punëve duke arritur rezultate, si pasojë e bashkëpunimit të mirë mes stafit ekzekutiv dhe stafit civil.

RENDI I PUNËS

1. Plani i punës së Kryetarit për vitin 2024.

Mehmet Ballazhi thekson: Rëndësia e debatit publik mbi Planin e punës së Kryetarit për vitin 2024 është i rëndësishëm sepse ky plan shkon për votim në Kuvend dhe nëse dikush nga ju jep ndonjë propozim për diçka konkrete, ne mund ta inkorporojmë në planin tonë qeverisës për 2023. Atëherë, disa nga fushat si prioritetet të mia të programit qeverisës për vitin 2024 janë: shërbimi ndaj qytetarëve, ngritja i shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale, rregullimet infrastrukturore dhe urbanistike, arsimit familja dhe siguria, zhvillimi ekonomik i qytetit, janë disa aktivitetet në vija përkufizuese, ndërsa detajet i keni brenda materialit, ku aktivitetet drejt arritjes së objektivave do të bëhen nga stafi i kabinetit, drejtoritë përkatëse, stafi i drejtorive dhe zyrat përgjegjëse. Ky plan ndoshta nuk është plani perfekt, por është i bazuar në faktorët kyq që janë për realizimin e këtij planifikimi , e një ndër faktorët kryesorë është buxheti që na e imponon ose determinon rezultatin e punës për vitin 2024 sipas planifikimit që është bërë në vitin 2023, e cili kalon të gjitha fazat, dalja në KPF, dëgjimi që po e mbajmë sot, më pas miratimi në Kuvend dhe pastaj shohim implementimin e tij në vitin 2024. Po prezentoj para jush edhe Planin. Atëherë ky plan ka pasur edhe grupin punues i përbërë nga të gjitha mekanizmat punues, Kryetar, Nënkryetar, Drejtorët/et dhe shefat e Zyreve. Në vazhdim po ju paraqes objektivat për vitin 2024: Stimulim i nxënësve për regjistrim në shkollat profesionale me mbulim të shpenzimeve të udhëtimit dhe studentëve të suksesshëm me bursa studentore, siç edhe e dini ne kemi marrë vendim që me u shtu edhe 10 studentë për bursa, si dh ekemi përfshi edhe studentët që studiojnë në Universitete publike në shtetet fqinje / Trajtimi i barabartë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe skemës sociale / Menaxhim cilësor dhe efektiv të buxhetit të komunës për vitin 2024 / Vazhdim i bashkëpunimit me institucionet qëndrore dhe lokale, Qeverinë,

IKSHPK, QKMF, etj / Transparençë digjitale për të gjitha aktivitetet në komunë dhe shpenzimet buxhetore / Krijimi i kushteve optimale për punë në çerdhen e fëmijëve / Vazhdim i përkrahjes së intuicioneve dhe aktiviteteve kulturore e sportive / Vazhdim i rritjes së shërbimeve në QKMF e AMF dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët / Realizimi cilësor i të gjitha projekteve të planifikuara / Miratimi i PZHK-së dhe harta zonale e komunës / Informimi i qytetarëve dhe përkrahja për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas ligjit për legalizime / Përmbyllja e projektit CDI-KOMUNË-KRU “BIFURKACIONI” për rehabilitimin e Fabrikës së ujit në prrockë të Dimcës si dhe vënia nën kontroll të ujit të pijshëm në Han të Elezit, ku edhe sot ne do ta përmbyllim një fazë të rëndësishme kur do ta bëjmë dorëzimin e aseteve tona tek Bifurkacioni / Inkurajimi dhe mbështetja e qytetarëve për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe përkrahja për hapje të bizneseve të reja / Vazhdimi i përkrahjes dhe stimulimi i fermerëve përmes subvencioneve / Bashkëpunim me komuna të ndryshme duke përfutur nga eksperienca e tyre dhe shembujt pozitiv / Bashkëpunimi ndërkombëtar për ndërkufitar me komuna / Bashkëpunim me institucione shtetërore, OJQ dhe institucione ndërkombëtare për prezntimin dhe afirmimin të komunës tonë / Digjitalizimi i Bibliotekës të qytetit të Hanit të Elezit / Përfundimi i investimeve në memorialin Billaca 99, ku ne kemi aplikuar në MZHR për shtrimin e rrugës që çon në memorial / Përfundimi i parkut Isa Berisha, ku gjatë vitit 2023 është realizuar auditimi social nga BIRN Kosova, ku ata kanë dhënë disa rekomandime dhe ka disa elemente që mund të përmirësohen / Krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe rekreative / Përfundimi i rrugës Paldenicë – Lagja Ramukë / Rikonstruktimi i urës së Seçishtës, ku mund të vendosim një aneks në pjesën tjetër të rrugës si shkak i kërkesave të qytetarëve, ku fillimisht duhet bërë një fizibilitet për mundësinë e realizimit të aneksit tjetër te ura. Mua më duhet me dal për me vazhdu tek takimi mes nesh, Bifurkacionit dhe Ministrisë së Ekonomisë në një ceremoni për dorëzimin e aseteve të fabrikës së ujit tek Bifurkacioni. Prezentimin do ta vazhdojë Nënkryetari, ndërsa juve iu lus që të bëheni pjesë e debatit dhe të jepni idetë, rekomandimet dhe sugjerimet tuaja për tu përfshirë në Plan.

Sevdi Derrjani: Përsëritet për të gjithë, ju falënderoj për pjesëmarrjen. Në pika të shkurta, Kryetari i Prezentoi Planin e Punës për vitin 2024, ku kisha dashtë me shtu që në këtë Plan ka si përmbajtje fjalimin e Kryetarit, dhe janë pesë shtyllat kryesore ku ne jemi fokusuar për vitin 2024, të cilat janë: shërbim ndaj qytetarëve , ngritja e shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale, rregullimet infrastrukturore dhe urbanistike, arsimit familja e siguria, si dhe zhvillimi ekonomik i qytetit. Në grupin punues të këtij plani janë: Kryetari, Nënkryetari, Zyra e Lignore, Zyra e Personelit, Zyra e Prokurimit, Zyra e Informimit, Zyra e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, si dhe gjithë drejtoritë. Ky plan është i harmonizuar me dëgjimet buxhetore të realizuara në vitin 2023 dhe me drejtoritë e zyret përkatëse. Nëse dikush ka ndonjë vërejtje, sugjerim, rekomandim, mund ta paraqes dhe po e hap diskutimin për këtë pikë, pra për Planin e Punës së Kryetarit për vitin 2024.

Hisni Luri: Deshta me u ndërlidh tek objektivi për digjitalizimin e bibliotekave , ku kemi në donacion prej organizatës CEO e cila po e ban digjitalizimin e të gjitha bibliotekave të Kosovës, një Platformë e quajtur Libri,ku shumicën e obligimeve e kryen organizata, ndërsa komuna participon me një pjesë të vogël si shenjë e partneritetit, andaj do ta shqyrtojmë këtë mundësi për bashkëpunim.

Ziber Xhoni: Përsëritet për të gjithë. E përgëzoj elaborimin e planit të punës për vitin 2024. Unë kam disa çështje për t'i diskutu; ne para 3 viteve e patëm ngrit si çështje për fushën e arsimit, ku arsimit i mesëm i lartë që ka qenë klasa e 12-të ku jemi e vetmja shkolle në Kosovë që e kemi si Rregullore gjithashtu e aprovueme edhe në Kuvendin Komunal, ku është taksa më e ulët në nivel komunal , unë kisha kërku tek DKA-ja dhe DBF-ja, të planifikohen “Shpallja e mësuesit të vitit” në nivel shkolle çmimi në vlerë 100 € dhe në nivel komunal 200 € sepse ne e kemi pas me Udhëzim Administrativ nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit , ku disa vite e kemi zbatu e disa vite jo, ku kemi pas pakënaqësi edhe brenda staffit të shkolles, si dhe me u paraparë edhe “Shpallja e sportistit të vitit” siç edhe e kanë shumica e komunave , e çmimi të jetë diku 300-400 €.

Sevdi Derrjani: Faleminderit drejtor për sugjerimet. Ky prezntim i sotëm është mbi planin e punës për vitin 2024, ndërsa planifikimi i buxhetit për vitin 2024 është bërë shumë herët , por si rekomandim do ta kemi parasysh, në mënyrë që me i stimulu edhe këto kategori që i përmendët.

Hisni Luri: Ne do ta kemi parasysh këtë pjesë për shpalljen e mësuesit të vitit, e kemi një Rregullore për subvencionim, përfshihet edhe për mësimdhënësit, të cilët marrin pjesë në gara të ndryshme komunale , kombëtare dhe ndërkombëtare , dhe padyshim se mund të përfshihet edhe pjesa e subvencionimit.

Resul Suma: Përsëritet për të gjithë. Pash te investimet kapitale te Plani që disa projekte që i kemi kalu dhe votu në Kuvend, në Plan nuk janë, ose u kan naj lëshim teknik ose i keni paraqit ato që janë pak ma të rëndësishme.

Sevdi Dernjani: Plani i Punës është në vija të trasha, ndërsa specifikimet buxhetore i keni në Planin e buxhetit tek ai që edhe është votu në Kuvend. Në plan janë disa aktivitete që Kryetari i ka planifiku për vitin 2024, qysh e thash edhe pak ma herët janë 5 shtylla ku Kryetari është fokusuar , ndërsa si aktivitete janë paraqit ato në Plan në vija të trasha.

Lindita Ballazhi: Përsëritet të gjithëve. Si përgjigje për Resulin, të gjitha projektet kapitale të votuara në Kuvend janë të përfshira në buxhet, ndoshta nuk janë përfshirë të gjitha në planin e punën, por në projekt buxhet janë të gjitha, ku edhe në webfaqen komunale janë të publikuara, si edhe në Ligjin e ri të Buxhetit që do të dalin në janar.

Resul Suma: Në lidhje me zburimi, dekorit e të tilla, është një shumë mjaft e vogël, a është gabim teknik apo ashtu është planifiku.

Sevdi Dernjani: Është një kod buxhetor që DSHPE-ja e ka planifiku vetëm për me rujt kodin buxhetor.

Ziber Xhoni: E kam edhe një kërkesë, Zyra për Informim në komunë që është, është mirë që me ardh edhe nëpër shkolla për me marr foto dhe incizime, e shoh që pak rëndësi i është kushtu kësaj pjese, sepse janë bo shumë punë, sidomos në SHML Dardania , ku janë vendos shkallët emergjente, janë digitalizu të gjitha klasat, në asnjë klasë nuk kemi projektor, etj, dhe do të ishte mirë me u dhanë si hapësirë publicitare edhe për juve , dhe jo vetëm te shkolla e mesme, por edhe te shkollat e tjera ku është bo një investim goxha i madh dhe e dimë se numri i nxënësve është në rënie e sipër, dhe pse jo edhe nxënësit e Gilloboçicës me i josh për me ardh në shkollat në Han të Elezit, ku përmes paraqitjes nga komuna, do t'i joshite infrastruktura ma e mirë e shkollave. Do të ishte mirë që Zyrën e Informimit me e angazhu ma tepër dhe me u bo nji promovim i punëve dhe infrastrukturës shkollore.


Sevdi Dernjani: Zyra e Informimit në institucionin komunal shpeshherë has në vështirësi për mbulimin e aktiviteteve të Kryetarit, e jo më me dal jashta institucionit komunal. Por unë ju sugjeroj juve që të gjitha ato aktivitete që i realizoni në shkollat tuaja t'i dërgoni në komunë dhe nuk do të ishte problem që ne me i postu aktivitetet në faqet e komunës.

Sevdi Dernjani: A keni edhe ndonjë diskutim për Planin që u prezentua sot? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur Debatin publik.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi





**Lista e pjesëmarrësve – takim me qytetarë lidhur me Planin e punës së Kryetarit
të Komunës për vitin 2024**

Data: 26.12.2023

Ora: 10:00

Vendi: Salla e Konferencave – Shtëpia e Kulturës

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni/Vendi	Telefoni	Nënskrimi
1	REMI BUSHI	ZYRTARI TË KADASTRËS	044/6191402	ABUJ
2	Natirra Kallisi	DAP	045 803 639	ABUJ
3	DIJESH VITOLI	SHKIL DAFENI	044354 001	ABUJ
4	Alim Bushi		044-408-955	ABUJ
5	Almet Berjanin	Zyre Prizren	044-137-937	ABUJ
6	Resul Suma	Kubend Komuna	046-134-554	ABUJ
7	Abdullahu Bushi	Drejtori Bujqësi	044 929 060	ABUJ
8	Alsim Dervishi	DSHPG	045-308-843	ABUJ
9	HISARI LUKI	DEARS	044-309 734	ABUJ
10	Nexhmedin Dili	Jurisdikc. Vrbanin	044-231-985	ABUJ
11	JURIDIKCJA BASHKICIA	ZYRA E KRYETARIT	044-862-571	ABUJ
12	Muharrem Ismaili	Z. Kultur. Prizren	044-280-616	ABUJ
13	Burim Jusufi	Zyrtarë	044-280-616	ABUJ
14	AMIR BASHI	Zyrtarë	044/210-363	ABUJ
15	MARJON MARJON	DAP	049994-659	ABUJ
16	Ljushita DALLASHI	D.B.F	049532 400	ABUJ
17	AMIR ALIJA	DSHMS	049691-560	ABUJ
18	BARUNH LAGI	PRIZREN	044-446-887	ABUJ
19	AMIR ORJANI	DEHE	044-811-685	ABUJ
20	Betir Dervishi	Zyrtarë e Bujqësi Prizren	044/489-307	ABUJ
21	SEVIME BASHI	Zyrtarë Prizren	044/256 162	ABUJ
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				